



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit nr 03/L-040, Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008) neni 10 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 35/17, dhjetor 2012) lidhur me nenin 24 dhe 25 të Rregullores QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, të nenit 5 dhe 18 të Statutit të Komunës së Mamushës, 01. nr. 001-2008, të dt. 01.12.2008, kërkesës së MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me nr. të referencës DDSHM 04-040/2023 Kuvendi i Komunës së Mamushës pas shqyrtimit të kërkesës, në mbledhjen e mbajtur me datën 31.03.2023 Kuvendi Komunal në Mamushë mori këtë:

V E N D I M

***Për dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës
për Policinë e Republikës së Kosovës***

I

MIRATOHET: propozimi i Kryetarit të Komunës së Mamushës në bazë të Kërkesës së parashtruar nga Ministria e Punëve të Mbrendshme/ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, kërkesa për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Policisë së Kosovës, me nr të referencës DDSHM 04-040/2023 pa procedurë të rregullt të Konkurrimit bazuar në ligjet në fuqi.

II

Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, është e ashtu quajtura ish- Shtëpia e Kulturës dhe i ka këto karakteristika parcela me numër të ngastrës katastrale P-73213054-01857-0 me sipërfaqe prej 2884 m², Certifikata e Pronësisë Zona Katastrale Mamushë, vend i quajtur Petrovica.

III

Qëllimi i dhënjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin II të këtij vendimi është ndërimi i objektit të ri për Stacionin Policisë së Kosovës, Stacioni në Mamushë, pasi që objekti në fjalë është më e përshtatshme për Policinë e Republikës së Kosovës.

IV

Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të përshkruar në nenin II të këtij vendimi jepet në shfrytëzim prej 10 (dhjetë) vitesh, me mundësi vazhdimi

V

Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në nenin II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim. Me qëllim të rikthimit të objektit në shfrytëzim të Komunës, me kusht që të njëjtëve të iu jepet në shfrytëzim një objekt tjetër në pronësi Komunale.

VI

Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në nenin II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastral të Kosovës.

VII

Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës së Mamushës dhe përfaqësuesit, të Policisë së Kosovës.

VIII

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Mamushës.

IX

Pjese përbërse të këtij vendimi janë

- Kërkesa
- Kopja e Planit
- Certifikata e Pronësisë

X

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Publikimit në Gjuhën Zyrtare në Wep-faqën e Komunës së Mamushës.

Kryetari i Kuvendit

Neumedin Morina





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih
Poslova / Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska
Direkcija / General Police Directorate



LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCE:		DDSHM-08-040/2023			
PËR/ZA/TO:		Z. Abdulhadi Krasniç Kryetar i Komunës - Mamushë			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		z. Fehmi Hoti UD. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës DPP - Prishtinë			
NGA/OD/FROM:		z. Faimir Bajrami Drejtor i Departamentit për Shërbime Mbështetëse DPP - Prishtinë			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të ndërtesës dhe pronës për Policinë e Kosovës			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:	DPP- Prishtinë	Data:	26.01.2023
Br. kancelarije:		Kucni:	Policia e Kosovës	Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☐
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☐
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☒
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					☐

I nderuar z. Krasniç,

Fillimisht, dëshiroj të shpreh mirënjohjen dhe faleminderim të lartë për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme ofruar Policisë së Kosovës, për të mundësuar realizimin e detyrave dhe përgjegjësi për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike në komunën e Mamushës

Duke u bazuar në kërkesën/njoftimin tuaj për lirim të objektit në të cilin është vendosur Stacioni Policor i Mamushës si dhe zotimin për sigurimin e hapësirës /objektit të ri për dislokimin e personelit dhe pajisjeve të këtij stacioni policor në objektin e Shtëpisë së Kulturës në ngastrën kadastrale P-73213054-01857-0 në sipërfaqe prej 2800m² ju drejtohem me kërkesë që Komuna e Mamushës, t'i ofrojë Policisë së Kosovës në shfrytëzim (posedim) ndërtesën /objektin e lartcekur (Shtëpisë së Kulturës në ngastrën kadastrale nr. P-73213054-01857-0 në sipërfaqe prej 2800m²) për afat të pacaktuar kohor për sistemimin e personelit policor të Stacionit Policor Mamushë.

Konform kërkesave të pranuara, koordinimit dhe takimeve të zhvilluara mes eprorëve të Drejtorisë Rajonale të Policisë - Prizren dhe komunës suaj si dhe vlerësimeve operative/teknike, Policia e Kosovës ka vlerësuar se objekti i propozuar i përmbush nevojat për sistemimin e stafit dhe vazhdimin e punës së stacionit policor Mamushë në objektin e propozuar, por pasi që ky objekt ka nevojë për renovim, me mirësjellje kërkojmë që deri sa të përfundojnë punimet dhe të krijohen kushtet për punë, personeli të vazhdojë punën në objektin aktual.

Andaj, nisur nga faktet e sipërpërmendura, dhe nevojës për krijimin e kushteve optimale për punë me qëllim të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike në këtë Komunë, me mirësjellje kërkojmë nga ju që të shqyrtohet me prioritet kërkesa për dhënien në shfrytëzim të objektit / parcelës me numër P-73213054-01857-0, për afat të pacaktuar kohor, me qëllim të mundësimit të përfundimit të procedurave përkatëse për zhvillimin e punimeve në renovimin / adaptimin e objektit sipas nevojave për sistemimin e personelit policor.



Republika e Kosovës – Kësova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosovo-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlaza - Outgoing	
02	No.Nr. 148-22
Tarih/Date	28.06.2022



TARİH: DATE/A:	29.06.2022
REFERANS:REFERENC-E:	Policiat e Kosoves.-Drejtorija Rajonale Prizren
KIME/PËR/ZA/TO:	
CGH	
KIMINONERISËYLE/PËRMES/ PREKO/THROUGH:	
KIMDEN/NGA/OD/FROM:	Kryetari i Komunes se Mamushes-Abdülhadi Krasniq
KONU/TEMA/SUBJKA/SUBJEKT:	Kërkesë



Iu drejtohem me kërkesë që ta lironi Objektin e Aneksit të shkollës fillore në Mamushë ku është i vendosur Stacioni Policor i Mamushës

Theksojmë se në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Mamushës 01.nr. 08-11 datë 17 Qershor 2011 iu ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm të Aneksit të objektit të shkollës fillore në Mamushë i locuar në ngastrën kadastrale nr. 932-0 në sipërfaqe prej 414.m² kurse vetëm aneksi i objektit ka 162.7 m²

Polici së Kosovës, iu drejtohem me kërkesë që ti rikthehet Objekti i përmendur Komunës së Mamushës, pasi që në atë objekt kemi hartuar projektin përndërtim të një Parku.

Po ashtu iu theksoi se në mbledhjet e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Mamushës do të merret Vendimi i ri për sigurimin e hapësirës për vendosjen e Stacionit Policor në Objektiv e Shtëpisë së Kulturës në ngastrën kadastrale nr.1857-0 dhe me sipërfaqe prej 2800m², edhe pse Vendimi 01.Nr.02/17 me datë 28 Shkurt 2017 ka qenë e vlevshme për një periudh kohore 5(pesë) vjeçare Kuvendi Komunal i Mamushës do të merr vendim për shtyerjen e periudhës kohore dhe rikthimin për shfrytëzim të Objektit të Shtëpisë së Kulturës.

Konsideroi se së shpejti do të na lajmëroni për lirimin e Objektit të Aneksit të shkollës fillore.

Shtojcë:

Vendimi 01.nr. 08-11 datë 17 Qershor 2011

Vendimi 01.nr 02-17 datë 28 Shkurt 2017



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Mamushës

P-66/2023

Numri i lëndës / Bruj Predmet / Case Referent Number:

27.03.2023 - 11:07

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

MAMUSHË / MAMUSHE / MAMUSHË

Komuna / Opština / Municipality:

MAMUSHË / MAMUSHE / MAMUSHË

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizimit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Identi broj/broj poslovanja ID. No.	Shëtitë e shëtitësit registrimit Drzava državljanstva ili ukupljenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
Komuna e Mamushës				600272512	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO		24.12.2020	28.12.2020

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Azurirano Updated
/		SAAT KULESI		28.12.2020



B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësish Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Katë/ Katet Be-Sprat at/ Spratova Floor number	Vendi i kualitor Zsano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deu imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Ažurirano Updated
P-73213054-01857-0	MAMUSHË / MAMUSHE / MAMUSHE	Mamushë / Mamuša / Mamushë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		PE-TROVICA- / PE-TROVICA- / PE-TROVICA-	2884	Bujqësori - Kullosat - Kulose E Klases 3 / / Poljoprivredno - Pasnjak - Pasnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class pasture / /	1 / 1	Posedim individual Individualna Drzavina / Single possessor	13.02.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MAMUSHË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Mamushë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-73213054-01857-0	Parcelë / Parcela / Parcel	2884



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 31.03.2023

Koha/ Vreme/ Time: 11:11:05

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



PARASHITRESË

Te nderuar,

Komuna e Mamushës ka pranuar një Kërkesë për dhënje në shfrytëzim të pronës Komunale bazuar në **LIGJI NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS** si dhe **RREGULLORE (QRK) Nr. 09/2020 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**.

Komuna e Mamushës edhe në bazë të kërkesës edhe të saj mund që ta jep në shfrytëzim Objektin e Kerkuar, po ashtu edhe te ofruar nga Komuna e Mamushës.

Por vlen të theksohet se në Kërkesën e Drejtorisë së përgjithshme të Policisë me nr të referncës DDSHM-08-040/2023, potencohet si Shtëpia e Kulturës, por që objekti nuk është më në shfrytëzim si shtëpi e Kulturës, por vetëm se ka qenë në të kaluarën Shtëpi e Kulturës dhe se ashtu i ka mbetur edhe emri, qëllimi i kësaj parashitre është me qëllim të njoftimit se nuk objekti në fjalë nuk është Shtëpi e Kulturës, pasi që pot të ishte ashtu Komuna do ta Refuzonte këtë kërkesë pasi që është në kundërshtim me vetë **RREGULLORE (QRK) Nr. 09/2020 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS** respektivisht nenin 7 pargafin 1 pika 1,2.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të njëtën praktik e ka përdorur edhe në Kryeqytet me të cilin janë drejtuar me një kërkesë të ngjashme, dhe se është miratuar Ligjshmëria e aktit administrativ.

Për sa i përket sipërfaqës së shënuar 2884 m² është sipërfaqe e tërsishme e hapësirës ku edhe ndodhet objekti, prone shoqërore. Shfrytëzimi i hapësirës do të bëhet vetem tek objekti (ndërtesa) si dhe një pjesë e oborrit që do të shfrytëzohet për parking për vetura zyrtare të PK.